



Organizata për Sigurim dhe Bashkëpunim në Evropë
Prezenca në Shqipëri



Republika e Shqipërisë
Avokati i Popullit

DEKLARATË PËR SHTYP

Prezenca e OSBE-së prezanton projektin për të drejtën për informim

TIRANË, 3 tetor 2006 – Një projekt, që ka për synim të ndihmojë shqiptarët të njohin më mirë të drejtat e tyre për informim, u prezantua sot nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe Avokati i Popullit.

Në kuadër të projektit “Njihni të drejtat tuaja”, të financuar nga Prezenca dhe qeveria franceze, pjesë dhe përmbledhje të legjislacionit shqiptar do të vendosen në ndërtesat e institucioneve shtetërore dhe në vende të tjera të dukshme në të tërë vendin.

Deri më tani, mbi 150 tabela janë vendosur në qarqet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës, Kukësit, Fierit, Korçës, Vlorës dhe Gjirokastrës. Ato informojnë publikun për të drejtën e tyre për të marrë dokumente zyrtare dhe informacion për çështjet e mjedisit, si dhe për të drejtat e të ndaluarve dhe arrestuarve. Gjithashtu, janë prodhuar broshura, që përmbajnë tekste më të gjata ose të plota të ligjeve përkatëse.

Projekti “Njihni të drejtat tuaja” synon të rrisë transparencën e institucioneve shtetërore dhe zbatimin e ligjeve në fuqi”, tha kryetari i Prezencës së OSBE-së në Shqipëri, Ambasadori Pavel Vacek. “Gjithashtu, ai synon t’i bëjë njerëzit më të ndërgjegjshëm për të drejtat e tyre për të kërkuar informacion dhe të përmirësojë aftësinë e tyre për ta marrë atë”.

Sipas Avokatit të Popullit, Ermir Dobjani, informimi i qytetarëve lidhur me të drejtën e tyre për të marrë dokumente zyrtare mbetet një nga përparësitë e zyrës së tij në përpjekje për të promovuar shtetin ligjor dhe mirëqeverisjen në Shqipëri. “Për këtë arsye ky projekt ka marrë mbështetjen e Avokatit të Popullit”, tha ai.

Projekti po zbatohet në bashkëpunim me ministritë e Brendshme, të Drejtësisë, të Mjedisit, të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Shëndetësisë. Partnerë të tjerë mbështetës janë Prokuroria e Përgjithshme, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, si dhe këshillat e qarkut dhe bashkitë.

Prezenca e OSBE-së është e gatshme t’u ofrojë asistencë të mëtejshme institucioneve shqiptare për të përforcuar zbatimin e legjislacionit aktual për të drejtën për informim.

Për më tepër informacion, jeni të lutur të lidheni me **Zyrën e Marrëdhënieve me Publikun dhe të Medias të Prezencës së OSBE-së në Shqipëri**, Sheraton Tirana Hotel & Towers, Kati I, Sheshi “Italia”, Tiranë, Shqipëri, Tel: +355 4 235 993, faks: +355 4 244 204, e-mail: pamo-al@osce.org, faqja në internet: www.osce.org/albania